



Shtesa dhe ndryshime në lidhje me procedurat, dokumentacionin dhe masën e përfitimit të ndihmës financiare për të punësuarit në subjekte me të ardhura vjetore deri në 14 milionë lekë, si dhe për përfituesit e ndihmës ekonomike dhe pagesës së të ardhurave nga papunësia

Në vijim të Njoftimit tone nr. 28 në lidhje me masat e marra nga qeveria dhe organet kompetente për të luftuar dhe kufizuar përhapjen e Covid-19, në Fletoren Zyrtare nr. 65 datë 13.04.2020, është publikuar Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 284, datë 10.04.2020 ("VKM ndryshuese"), në mbështetje të Vendimit të Komitetit Ndërmintor të Emergjencave Civile nr. 7 datë 09.04.2020, të cilat sjellin disa ndryshime dhe shtesa në VKM nr. 254 datë 27.03.2020, "Për procedurat, dokumentacionin dhe masën e përfitimit të ndihmës financiare për të punësuarit në biznese me të ardhura vjetore deri në 14 milionë lekë, si dhe ndihmën për përfituesit e ndihmës ekonomike dhe përfituesit e të ardhurës nga papunësia gjatë periudhës së fatkeqësisë natyrore Covid-19".

Sipas VKM-së ndryshuese përjashtohen nga përfitimi i ndihmës financiare mujore në shumën 26,000 lekë:

1. Individët që janë të punësuar në më shumë se një shoqëri, kur të paktën njëra prej shoqërive në të cilat individi është i punësuar, nuk është e përfshirë në listen e veprimtarive ekonomike të mbyllura si pasojë e masave të marra në kuadër të parandalimit të përhapjes së Covid-19; dhe
2. Individët e vetëpunësuar ose të punësuar, të cilët gjatë vitit 2019 kanë gjeneruar të ardhura bruto nga paga mbi 2 milionë lekë.

Parashikimet e mësipërme hyjnë në fuqi në mënyrë të menjëhershme duke filluar nga data 13.04.2020.

Pezullimi i detyrimit të qirasë dhe rregulla të posacme për Bizneset e Përpunimit Aktiv

Në Fletoren Zyrtare nr. 65 u publikua Akti Normativ nr. 14, datë 11.04.2020 "Për disa ndryshime dhe shtesa në aktin normativ nr. 3, date 15.03.2020, të Këshillit të Ministrave "Për marrjen e masave të veçanta administrative gjatë kohëzgjatjes së periudhës së infeksionit të shkaktuar nga Covid-19" (Akti Normativ 14).

Në Aktin Normativ nr.3 bëhen ndryshimet e mëposhtme:

- Të gjithë qiramarrësit, persona fizikë/juridikë, me të ardhura deri në 14 milionë lekë në vit, të cilët kanë kontratë noteriale qiraje për zhvillimin e aktivitetit të tyre ekonomik, të nënshkruar përpara shpalljes së gjendjes së epidemisë, pavarësisht nëse e kanë të lejuar apo të ndaluar aktivitetin si pasojë e gjendjes së shkaktuar nga Covid-19, nuk do ta paguajnë detyrimin e qirasë për dy muaj, prill dhe maj 2020.



Parashikohen rregullat si më poshtë për Bizneset e Përpunimit Aktiv:

- i.** Autoritetet kontraktore, me qëllim përmbushjen e nevojave për mallra/shërbime të nevojshme, për një kohë lëvrimi shumë të shkurtër, ose për raste veçanërisht të leverdisshme, që paraqiten në një kohë shumë të shkurtër dhe me një çmim më të ulët se çmimet normale të tregut, për përballimin e situatës së krijuar nga epidemia e shkaktuar nga Covid-19, gjatë gjithë kohëzgjatjes së saj, për përballimin e nevojave emergjente, kryejnë procedura prokurimi me negociim, pa shpallje papaprake të njoftimit dhe lidhin kontratat e furnizimit për këto mallra me operatorët ekonomikë të referuar si “biznesi i përpunimit aktiv”, sipas parashikimeve të Kodit Doganor.
- ii.** Bizneset e përpunimit aktiv, që prodhojnë mallra ose ofrojnë shërbime të nevojshme për përballimin e situatës së krijuar nga Covid-19, pas hyrjes në fuqi të këtij akti normativ, nëse kanë mallra/shërbime të leverdisshme, shprehin disponibilitetin e tyre pranë Agjencisë së Blerjeve të Përqendruara (ABP).
- iii.** Autoritetet kontraktore do të negociojnë vetëm me operatorët e listuar në ABP, sipas mallrave/shërbimeve që duan të prokurojnë. ABP-ja ka detyrimin të përditësojë çdo ditë listën e bizneseve që shprehin disponibilitetin e tyre.
- iv.** Nëse nevoja nuk mund të plotësohet nga këta operatorë, autoritetet kontraktore mund t'i drejtohen operatorëve të tjerë ekonomikë për përmbushjen e kërkesës për këto mallra, sipas procedurës me negociim, pa shpallje papaprake të njoftimit.
- v.** Përrjashtohen nga rregulli i përcaktuar si më lart të gjitha procedurat që përdoren për lidhjen e kontratave që diktohen nga interesa thelbësorë të shtetit.

Akt Normativ 14 hyn në fuqi menjëherë.



Additions and amendments regarding procedures, documentation and amount of financial assistance for employees working in entities with annual income up to ALL 14 million, as well as for beneficiaries of economic aid and unemployment income

Following our Notification no. 28 related to the measures taken by the government and by the relevant competent institutions to fight and limit the spread of Covid-19, in the Official Gazette no. 65, dated 13.04.2020, is published the Decision of the Council of Ministers no. 284, dated 10.04.2020 ("Amending DCM"), in support of the Decision of the Inter-Ministerial Committee on Civil Emergencies no. 7, dated 09.04.2020, which brings some additions and amendments to the DCM no. 254, dated 27.03.2020 "On procedures, documentation and amount of financial assistance to employees working in businesses with annual income of up to ALL 14 million, as well as assistance to beneficiaries of economic aid and recipients of unemployment income, during the period of natural disaster Covid-19". According to the Amending DCM are exempt from benefitting the monthly financial assistance amounting to ALL 26,000:

1. Individuals who are employed in more than one company, when at least one of the companies in which the individual is employed, is not included in the list of closed economic activities as a result of the measures taken in order to prevent the spread of Covid-19; and
2. Self-employed or employed individuals, which during 2019 have generated gross income from salary over ALL 2 million.

The above legal provisions are effective immediately starting on 13.04.2020.

Suspension of rent and special rules for the Active Processing Businesses

In the Official Gazette no. 65 is published the Normative Act no. 14, dated 11.04.2020 "On some changes and additions to the Normative Act no. 3, dated 15.03.2020, of the Council of Ministers "On special administrative measures during the infection period caused by Covid-19"" (**Normative Act 14**).

In the **Normative Act no. 3** the following changes are made:

- All lessees natural / legal persons with incomes up to ALL 14 million per year, who have a notarial lease contract for the development of their economic activity, signed prior to the declaration of the state of the epidemic, whether it is permitted or prohibited activity as a result of the situation caused by Covid-19, will not pay the rent for two months, April and May 2020.



The following rules for the Active Processing Businesses are provided:

- i.** Contracting authorities, in order to meet the needs for necessary goods/services, for a very short delivery time, or for particularly convenient cases, which are presented in a very short time and at a lower price than normal market prices, to cope with the situation created by the epidemic caused by Covid-19, during all its duration, to meet the emergency needs, perform procurement procedures with negotiation, without public announcement and enter into supply contracts for these goods with economic operators referred to as “active processing businesses”, as provided by the Customs Code.
- ii.** Active processing businesses, which produce goods or provide services necessary to cope with the situation created by Covid-19, after the entry into force of this normative act, if they have goods/convenient services, in the sense of this article, express their availability at the Centralized Purchasing Agency (ABP).
- iii.** Contracting authorities will only negotiate with the operators listed in ABP, according to the goods/services they want to procure. ABP has the obligation to update the list of businesses that express their availability every day.
- iv.** If needs cannot be met by these operators, the contracting authorities may turn to other economic operators to meet the demand for these goods, in accordance with negotiated procedure, without prior notice.
- v.** All the procedures used for concluding contracts that are dictated by the essential interests of the state are excluded from the rule defined as above.

Normative Act 14 shall enter into force immediately.